

Komunikojmë

Buletin tremujor mbi projektet për sistemin e drejtësisë në Shqipëri

JANAR – MARS 2011

NUMRI 1

NË KËTË NUMËR:

VEPRIMTARITË JANAR – MARS 2011

Tryeza të rrumbullakëta mbi nevojën për një reformë tërësore të kodit të procedurës penale _____ 1

Nivel më i lartë transparence në emërimin e gjyqtarëve _____ 1

Për praktika të efektshme të Shërbimit të Provës në Shqipëri _____ 2

Mbështetje e BE-së për Shërbimin e Provës në Shqipëri si dhe zhvillime të mëtejshme lidhur me masat alternative të dënimit _____ 2

Identifikimi i sfidave dhe formulimi i zgjidhjeve drejt forcimit të avokatisë në Shqipëri _____ 2

Ndërtimi i lidhjeve me partnerët e shoqërisë civile dhe medias për një drejtësi më transparente, të efektshme dhe të përgjegjshme _____ 3

Konkurset e Gjyqit Imities për studentët e juridikut _____ 3

Shqipëria ka një ligj të ri për ndërmjetësimin _____ 3

VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË PRILL – QERSHOR 2011



Të nderuar lexues,

Kam kënaqësinë të përshëndes botimin e këtij buletini si një nismë me anë të së cilës ne, aktorët e sistemit të drejtësisë, do të kemi mundësi të Komunikojmë! Dëshira për të pasur një sistem gjyqësor efikas dhe të aftë që t'i përgjigjet në kohë zhvillimit ekonomik të vendit, ka nxitur partnerët tanë ndërkombëtarë që t'i gjenden në krahë të gjithë atyre që duan një gjykatë dhe një sistem drejtësie me fytyrë të freskët ku të pasqyrohet dëshira për një zhvillim të qëndrueshëm dhe dobiprurës. Në kuadër të këtyre dëshirave vjen edhe ky komunikim elektronik, në të cilin do mund të gjejmë vend dhe zë të gjithë së bashku.

Sistemi gjyqësor në Shqipëri ka probleme të cilat mund të zgjidhen vetëm me asistencën e miqve tanë ndërkombëtarë.

Në këto pak rreshta dua të theksoj vetëm një detaj që në të ardhmen mund të bëhet shqetësimi më i madh i gjykatave, mungesën pothuaj totale të një sistemi elektronik komunikimi. Këtu bëhet fjalë për një sistem i cili do të jetë i aftë t'i kthejë përgjigje dhe të zgjidhë administrimin e sallave të gjyqit; shortin e çështjeve gjyqësore; komunikimin e gjyqtarëve me njëri-tjetrin, jo vetëm brenda gjykatës, por edhe midis gjykatave të ndryshme; komunikimin e gjykatave me institucionet e tjera të drejtësisë etj. Sistemet aktuale janë ose të mangëta, ose të pazhvuara mirë. Pasja e një sistemi të vetëm të centralizuar dhe lehtësisht të përdorshëm është më se e nevojshme. Nga ana tjetër kjo do të bënte më të lehtë për publikun që të lidhej me gjykatën në distancë pa qenë nevoja e paraqitjes në ambientet e saj. Shpreh bindjen se pajimet teknologjike do të jenë një sfidë e së ardhmes për gjykatat e Shqipërisë, por kjo është koha e duhur për t'u përballur me to duke pasur në krahë dhe ndihmën e vyer të USAID.

Duke ju uruar punë të mbarë, shpreh edhe njëherë gatishmërinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të ndihmuar në gjitha nismat për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Sinqerisht,

Kreshnik Spahiu

Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

VEPRIMTARITË NË JANAR – MARS 2011

Tryeza të rrumbullakëta mbi nevojën për një reformë tërësore të kodit të procedurës penale

Në bashkëpunim të ngushtë me EURALIUS, USAID, PAMECA, ICITAP, OSBE si dhe Ministrinë e Drejtësisë, OPDAT (Zyra e SH.B.A.-së për Zhvillimin, Ndihmën dhe Trajnimin për Prokuroritë Jashtë Vendit) organizoi disa tryeza të rrumbullakëta mbi nevojën për një reformë tërësore të procedurës penale në Shqipëri. Këto tryeza të rrumbullakëta, të cilat u zhvilluan në Shkodër (7 mars), Vlorë (9 mars) dhe Tiranë (11 mars), u realizuan në formën e forumeve për të diskutuar mbi drejtimit ku ka nevojë për ndryshim, si zhvillimi i gjyqeve të pandërprera dhe fuqia e dënimit për mosrespektim të gjykatës, afatet kohore gjatë hetimit dhe rregullat që lidhen me administrimin e provave,

gjykimi i shkurtuar dhe imuniteti i zyrtarëve publikë. Ambasadori i SHBA-së, Zëvendës ambasadori i Delegacionit të BE-së në Tiranë, Ministri i Drejtësisë, Prokurorja e Përgjithshme dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbajtën fjalime gjatë tryezës së rrumbullakët në Tiranë. Ata u shprehën në mbështetje të reformës në fushën e procedurës penale dhe vunë theksin mbi nevojën për të bërë ndryshime lidhur me imunitetin kushtetues të deputetëve, gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë. Këto tryeza ishin pjesë e zbatimit nga OPDAT të një nga komponentëve të Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II (MCCA2), angazhimi i të cilit është krijimi, pajisja dhe trajnimi i gjashtë Njësisë të Përbashkëta Investigative për të luftuar krimin ekonomik dhe korrupsionin. Reforma e Kodit të Procedurës Penale është domosdoshmëri për ndjekjen me sukses dhe në numër në rritje të rasteve të korrupsionit.

Nivel më i lartë transparence në emërimin e gjyqtarëve

Në takimim e tij të datës 16 shkurt 2011, Këshilli i Lartë i Drejtësisë miratoi projekt-vendimin "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kandidatëve për Gjyqtarë". Hartimi i këtij vendimi u realizua me ndihmën e projektit të BE-së "Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri" (EURALIUS) dhe ishte produkt i një grupi pune që përfshinte edhe përfaqësues të shoqatave të gjyqtarëve dhe disa kryetarë gjykatash. Duke reflektuar nevojat e evidentuara gjatë punës së Komisionit dhe i bazuar në rekomandimet e raport-progresit më të fundit të Komisionit Evropian, ky vendim synon rritjen e transparencës, profesionalizmit dhe integritetit në procesin e emërimit të gjyqtarëve.

Për praktika të efektshme të Shërbimit të Provës në Shqipëri

Më 31 janar 2011, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe në kuadrin e projektit të saj për “Praktikat e Efektshme të Shërbimit të Provës në Shqipëri - Faza II”, Prezenca e



Tryeza e rrumbullakët mbi zhvillimin e një programi Master në Administrimin e Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë, 7 shkurt 2011.

OSBE-së në Shqipëri organizoi në Korçë një trajnim për 25 punonjës socialë të disa bashkive dhe komunave të përzgjedhura mbi çështje që lidhen me Shërbimin e Provës. Programi i trajnimit përfshinte planifikimin e çështjeve, vlerësimin e nevojave dhe problemeve të autorëve të veprave penale, programe për trajtimin e sjelljeve fyese, bashkëpunimin midis organeve të ndryshme për rehabilitimin e autorëve, punën me autorë problematikë dhe jo, si dhe punë në grupe dhe me autorë individualë për t'i ndihmuar në tejkalimin e sjelljeve agresive dhe të dhunshme.

Më 7 shkurt 2011, Prezenca organizoi një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar mbi zhvillimin e një programi të avancuar ndërdisiplinor studimesh me qëllim përmirësimin e standardeve të shërbimeve sociale, sidomos të atyre që ofrohen nga sistemi i drejtësisë. Universiteti i

Tiranës do të ofrojë Studime të nivelit Master në Administrimin e Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë duke filluar nga viti akademik 2011-2012. Ky program është projektuar në mënyrë të tillë që të edukojë dhe të trajtojë profesionistë dhe vullnetarë aktualë dhe të ardhshëm në punën me autorë të veprave penale në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Në diskutime morën pjesë zyrtarë të gjyqësorit, përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore, nga organizma ndërkombëtare dhe organizata të shoqërisë civile.

Në datat 17 dhe 18 shkurt, Prezenca zhvilloi një trajnim mbi çështjet menaxheriale për drejtorët dhe inspektorët e Shërbimit të Provës në Shqipëri. Dy ekspertë, një nga Rumania dhe një nga Shqipëria, trajnuan rreth 15 inspektorë dhe drejtorë të 8 zyrave rajonale të Shërbimit të Provës të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Elbasanit, Lezhës, Fierit, Korçës dhe Gjirokastrës për çështje që kanë lidhje me menaxhimin, duke përfshirë komunikimin, teknikat e negocimit, aftësitë udhëheqëse dhe ndarjen e rasteve.

Mbështetje e BE-së për Shërbimin e Provës në Shqipëri si dhe zhvillime të mëtejshme lidhur me masat alternative të dënimit

Projekti njëvjeçar i Bashkimit Evropian “Mbështetje për Reformën e Sistemit Penitenciar në Shqipëri”, me vlerë një


milion euro, u prezantua në Tiranë në 25 mars 2011 gjatë një ceremonie ku mori pjesë edhe Ministri i Drejtësisë i Mbretërisë së Bashkuar, Lordi Tom McNally, Ministri shqiptar i Drejtësisë, Bujar Nishani, dhe Shefi i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Ambasadori Ettore Sequi. Ky është një projekt binjakëzimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë dhe asaj të Mbretërisë së Bashkuar, me qëllim

promovimin dhe përmirësimin e dhënies së dënimeve alternative, si p.sh, shërbim për komunitetin, për persona që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore. Ai do të shërbejë për të ulur fenomenin e mbipopullimit nëpër burgje, për të lehtësuar menaxhimin e përgjithshëm të burgjeve dhe kostot përkatëse, si dhe për mbështetjen e mekanizmave të ri-integrimit dhe rehabilitimit të kundërvajtësve.

Identifikimi i sfidave dhe formulimi i zgjidhjeve drejt forcimit të profesionit të avokatisë në Shqipëri

Mbi 100 avokatë nga 11 rrethe të Shqipërisë: Vlora, Fieri, Berati, Tepelena, Durrësi, Tirana, Lushnja, Lezha, Kruja, Kurbini dhe Shkodra morën pjesë në tre tryeza bisedimi të organizuara gjatë periudhës dhjetor 2010 – janar 2011 në Vlorë, Durrës dhe Lezhë, me mbështetjen e Programit të USAID-it për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (JuST), për të diskutuar mbi sfidat me të cilat përballet avokatia në Shqipëri, si dhe për të formuluar rekomandime për kapërcimin e tyre. Gjatë këtyre takimeve, që u mundësuan falë bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë (DHKASH) dhe tre dhomat rajonale, pati mjaft diskutime lidhur me aktivitetin e brendshëm të

organizatës në nivel kombëtar dhe lokal, etikën dhe disiplinën profesionale, si dhe nevojën për trajnim vazhdues profesional. Informacion i rëndësishëm mbi çështje që lidhen me menaxhimin dhe vendimmarrjen, planifikimin dhe personelin, shërbimet për anëtarët dhe ngritjen e kapaciteteve u mblodh dhe nga formularët e vetë-vlerësimit të plotësuar nga pjesëmarrësit. Si rezultat, këto tryeza mundësuan formulimin e një sërë rekomandimesh, të cilat janë bërë tashmë pjesë e një raporti përmbledhës, i cili mund të gjendet në internet në adresën: www.albania.usaid.gov/JuST. Ato gjithashtu kontribuan dhe në formulimin e një plani të hollësishëm për ecurinë e mëtejshme të bashkëpunimit ndërmjet DHKASH-së dhe USAID-it. Tashmë ka filluar puna për tri nisma kryesore: ngritjen e programit të Arsimit Vazhdues Ligjor, botimin e Revistës Kombëtare të Avokatisë, dhe organizimin e një Konference Vjetore të Avokatisë në Shqipëri.



Kryetari i DHKASH-së, Maksim Haxhia (në të majtë), duke marrë kopjet e para të një botimi që përmblodh Ligjin mbi Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë, Statutin e DHKASH-së dhe Kodin Etik të Avokatisë, përmbljedhje e cila u përgatit dhe shpërnda në mbarë vendin përmes mbështetjes së projektit JuST të USAID-it, në përgjigje të një prej përfundimeve nga tryezat e rrumbullakëta mbi nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit të avokatëve lidhur me aktet themelore që rregullojnë profesionin e tyre në Shqipëri.

Konkurset e Gjyqit Imitues për studentët e juridikut

Për ta sjellë çështjen e korrupsionit në vëmendjen e publikut, si pjesë e veprimtarive në kuadrin e programit MCCA2, OPDAT organizoi Konkurse për Gjyqin Imitues në Universitetin e Vlorës (15 mars) dhe në Universitetin e Tiranës (17 mars), me pjesëmarrjen e studentëve të juridikut. Ekipet e formuara nga dy prokurorë dhe dy avokatë mbrojtës realizuan marrjen në pyetje të dëshmitarëve të secilës palë dhe mbajtën deklaratat hapëse dhe mbyllëse. Skenari përshkruante një çështje mitmarrjeje lidhur me një kontratë për mbetjet urbane, ku ishte i përfshirë një zyrtar publik i nivelit të mesëm dhe sipas fakteve ishte gjithashtu i inkriminuar edhe një zyrtar i një niveli më të lartë me imunitet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Pas vlerësimit të gjyqve imituese të zhvilluara, OPDAT, Prokurorë të Njesisë së Përbashkët Hetimore dhe profesorë u angazhuan në diskutime të gjalla me pjesëmarrësit lidhur me çështjen e korrupsionit. Gjyqet imituese u filmuan dhe parashikohet të shfaqen në fakultete të tjera të juridikut në Shqipëri.

Ndërtimi i lidhjeve me partnerët e shoqërisë civile dhe medias për një drejtësi më transparente, të efektshme dhe të përgjegjshme

Puna me shoqërinë civile dhe median për rritjen e rolit të tyre monitorues dhe antikorrupsion përbën një nga tri fushat kyçe të veprimtarisë së projektit pesëvjeçar JuST të USAID-it, i cili ka filluar në tetor 2010. Për t'i dhënë një shtysë procesit, në fillim të shkurtit 2011, JuST publikoi dy thirrje për shprehje interesi nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe medias për të bashkëpunuar me projektin, të cilave iu përgjigjën mbi 90 aplikime. Programi i bashkëpunimit përfshin një proces vlerësimi të nevojave, ngritje kapacitetesh, dhënien e granteve për organizatat e shoqërisë civile dhe krijimin e një forumi të pavarur të gazetarëve investigativë në Shqipëri. Ndërkohë, projekti JuST ka përfunduar vlerësimin e nevojave të Unionit të Gjyqtarëve Shqiptarë dhe Shoqatës së Gjyqtarëve Shqiptarë, si një hap i parë i rëndësishëm drejt forcimit të zërit të bashkuar të gjyqtarëve në reformën e sistemit të drejtësisë.

Shqipëria ka një ligj të ri për ndërmjetësimin

Më 24 shkurt 2011, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10385, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", të hartuar në përputhje me direktivën 2008/52/EC të BE-së. Ky ligj u dekretua nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë në 8 mars 2011 dhe u botua në Fletoren Zyrtare nr. 25, datë 25 mars 2011, me datën e hyrjes në fuqi 15 ditë pas botimit. Ky ligj e sanksionon ndërmjetësimin si një veprimtari të pavarur jashtëgjyqësore, që ndërmerret vullnetarisht nga palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre në fushën e të drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare, si dhe për disa raste në fushën e të drejtës penale. Ligji i ngarkon Ministrinë së Drejtësisë përgjegjësinë e krijimit dhe mbajtjes së Regjistrimit të Ndërmjetësve dhe parashikon ngritjen e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve. Ligji kërkon që gjyqtarët detyrimisht të ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të çështjeve të tyre në gjykatë, duke i dhënë kështu edhe një shtysë të mëtejshme mbështetjes së programeve ekzistuese të ndërmjetësimit, si p.sh. atij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, që është financuar nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe mbështetet nga USAID.

VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË PRILL – QERSHOR 2011

- Trajnim për Hetimin Financiar i ofruar për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore me mbështetjen e OPDAT, 4-15 prill 2011.
- Konferencë mbi Dhunën në Familje e mbështetur nga OPDAT dhe Zyrës së Ambasadës amerikane për Çështjet Publike, 18-22 prill 2011.
- Nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mbi ndërmjetësimin ndërmjet projektit JuST të USAID-it, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Fondacionit "Zgjidhja e Konfliktëve dhe Ndërmjetësimi i Mosmarrëveshjeve", 22 prill 2011.
- Konferencë Rajonale për Mbrojtjen e Dëshmitarëve e mbështetur nga OPDAT, 10-12 maj 2011.
- Finalizimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për ngritjen e Programit të Arsimimit Vazhdues Ligjor ndërmjet projektit JuST të USAID-it dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, maj 2011.
- Përfundimi i raportit për shfrytëzimin e sallave të gjyqit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, i realizuar në kuadrin e projektit JuST të USAID-it, maj 2011.
- Seminare trajnimi prezantuese për punonjësit e rinj të Shërbimit të Provës të organizuara nga Prania e OSBE-së në Shqipëri.



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

JuST

E-mail: office@ajssp.org.al
<http://albania.usaid.gov/JuST>



OPDAT

E-mail: EldridgeC@state.gov
<http://www.justice.gov/criminal/opdat>



Organization for Security and
Co-operation in Europe

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
E-mail: pm-al@osce.org
<http://www.osce.org/albania>



Delegacioni i BE-së në Shqipëri
E-mail: delegation-albania@ec.europa.eu
<http://www.delalb.ec.europa.eu>

Falenderimet dhe përgjegjësitë

Artikujt e këtij buletini janë kontribute të projekteve të donatorëve të cilët mbështesin aktivisht reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Kontribuuesit mbajnë përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e artikujve të tyre, të cilat nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve apo qeverive përkatëse.